



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije - Ministry of Education, Science,  
Technology and Innovation*

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**

**Thirrje për pjesëmarrje në Seminarin XVI për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë**

**“Teori dhe praktika të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë”**

Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës organizojnë *Seminarin XVI për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë* në datat **30 korrik – 2 gusht 2023, në Vlorë, Shqipëri.**

Seminari do të mbledhë mësues, specialistë, kërkues shkencorë, akademikë dhe studiues, me qëllim që, përmes ideve, mendimeve, strategjive dhe metodave të ndryshme, të kontribuohet për mësimdhënie cilësore të mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë e mërgatë.

**Tematikat e Seminarit:**

- Kompetencat e mësuesit dhe pjesëmarrja e nxënësve në mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë.
- Praktika të mësimdhënies së gjuhës shqipe në mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë.
- Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë.
- Mësimdhënia e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në mjedise shumëgjuhësore.
- Mësimdhënia e gjuhës shqipe për nxënës me nivele të ndryshme gjuhësore.

Ftohen të marrin pjesë mësues të mësimit plotësues në diasporë dhe në mërgatë, punonjës shkencorë dhe specialistë të arsimit.

Mësuesit e mësimit plotësues në diasporë, të interesuar për pjesëmarrje, ftohen të aplikojnë në linkun [https://docs.google.com/forms/d/1DFK1HoRef4WEURom3pwvcVi\\_CCAFTXnc6HoKkQY-b8M/viewform?edit\\_requested=true](https://docs.google.com/forms/d/1DFK1HoRef4WEURom3pwvcVi_CCAFTXnc6HoKkQY-b8M/viewform?edit_requested=true)

Të interesuarit për prezantime ftohen të aplikojnë me abstrakte në linkun [https://docs.google.com/forms/d/1nuob46r2v0HOomu\\_tiKMrL3FKK85OGYJofXMT0772EY/viewform?edit\\_requested=true](https://docs.google.com/forms/d/1nuob46r2v0HOomu_tiKMrL3FKK85OGYJofXMT0772EY/viewform?edit_requested=true)

Data të rëndësishme:

- Aplikimi për pjesëmarrje deri më 26 maj 2023.
- Dorëzimi i abstrakteve deri më 26 maj 2023.
- Njoftimi për pranimin apo refuzimin e prezantimeve deri në datë 6 qershor 2023.
- Dorëzimi paraprak i punimit deri më 20 korrik 2023.

**Ju mirëpresim në Vlorë!**